



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.805/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale, ndaj të pandehures A. A. nga fsh. J. K.Lipjan, të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.8555/14 të dt. 17.11.2016, për shkak të veprës penale, Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.11.04.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokuroritë shtetit M. L., dhe të pandehues, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

A. A., i biri i S., dhe i Xh, e gjinisë R., i lindur më *data e lindjes...*, në J. komuna Lipjan ku edhe jeton me numër personal të letërnjoftimit *numri përsonal...*, i pa punë, i nacionalitetit Rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 22.05.2012, i pandehuri A. A., me dashje ka vënë në lajthim Qëndrimin e Regjistrimit të Automjeteve në L., ashtu që në një dokument publik, regjistër apo libër të vertetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore të autorizuar të QKRA-së, së lartcekur ia prezenton dokumentin e falsifikuar – librezën e qarkullimit me prejardhje të Republikës së Serbisë, me nr.CP *numri...*, me targa *numri i targës...*, automjeti i tipit “Opel Omega”, me nr.të karrocërisë *numri i motorrit...*, ngjyrë të zezë metalike, e viti i prodhimit 1998, dhe arrin ta regjistroj me targa të Republikës së Kosovës *numri i targës...*,-

-me këtë ka kryer veprën penale, Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 403 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **400-€ (katërqind Euro)**, e të cilin dënim i akuzuari detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me burgim, në të kundërtën dënimi me gjobë konform nenit 46 par 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t’ia paguajë, shumën prej 20-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej

20-€, si dhe shumën prej 30.-€ në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.8555/14 të dt. 17.11.2016, e ka akuzuar të pandehurin A. A. për shkak të veprës penale penale, Legalizim i përmbarjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ky i bere ne menyre vullnetare, pa presion dhe konform dispozitave te nenit 428 te KPRK-së, i propozoj gjykatës qe te njëjtin ta shpalle fajtor dhe t'i shqiptoj sanksionin penal dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, e njëjta e ka pranuar fajësinë dhe e ndien veten fajtor për veprën penale qe i vihet ne barre dhe njëherit shton se është i gjendjes së vështir ekonomike, i nacionalitetit Rom, dhe i propozon gjykatës qe t'i shqiptoj nje dënim sa me te butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes qe i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehures, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehuren, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale, pra faktin se e pandehura është i nacionalitetit rom, dhe i gjendjes së dobët ekonomike, pendimin, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehures, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së, Vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

P.nr.805/16 të dt.11.04.2018

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.